

VENDIM
Nr. 56, datë 24.2.2023

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “KURUM INTERNATIONAL” SHA, PËR
MODIFIKIMIN E LICENCËS NR. 213, SERIA PM13P PËR PRODHIMIN E ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA HEC-i “SHKOPET”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 10, pika 3 dhe nenit 15, pika 4 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.2.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 133/2 prot., datë 23.2.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Kurum International’ sh.a. për modifikimin e licencës nr. 213, seria PM13P, miratuar me vendimin nr. 132, datë 6.12.2011 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s dhe transferuar me vendimin nr. 126, datë 28.10.2023, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s të shoqëria ‘Kurum International’ sh.a. për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-i ‘Shkopet’”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 351, datë 28.12.2022, vendosi të mos fillojë procedurën për modifikimin e licencës nr. 213, seria PM13P, miratuar me vendimin nr. 132, datë 6.12.2011 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s dhe transferuar me vendimin nr. 126, datë 28.10.2013, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s të shoqëria “Kurum International” sh.a. për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-i “Shkopet” me kapacitet të instaluar 24 mw.

- Në vijim, ERE me shkresën me nr. 133 prot., datë 16.1.2023, ka njoftuar shoqërinë për këtë vendim dhe i ka bërë me dije se, në mbështetje të përcaktimeve të nenit 10, pika 7 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, nëse shoqëria, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijeni e vendimit për mosfillimin e procedurës, paraqet dokumentacionin thelbësor të konstatuar të munguar, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.

- Shoqëria “Kurum International” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 133/1 prot., datë 15.2.2023, brenda afatit të sipërcituar (shkresa e ERE-s nr. 133 prot., datë 16.1.2023, është marrë nga shërbimi postar në datën 16.1.2023 dhe duke llogaritur afatin tre ditor të dërgimit të saj mbështetur në Kodin e Procedurave Administrative, rezulton se shoqëria ka marrë dijeni për këtë shkresë në datën 19.1.2023). Me shkresën e sipërcituar shoqëria ka përcjellë dokumentacion plotësues për aplikimin e saj për modifikimin e licencës së veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike.

- Aplikuesi bën me dije se kërkesa për modifikim ka ardhur për arsye se në maj 2023 kjo shoqëri ka programuar rehabilitimin e HEC “Shkopet”, “optimizimi i operimit të turbinave”, gjatë të cilit do të zëvendësohen disa nga pajisjet kryesore të centralit dhe do të instalohen pajisje të reja dhe do të ketë një shtesë kapaciteti prej 4 mw dhe fuqia nominale do të jetë $P_n=28$ mw.

Duke qenë se rritja e kapacitetit të instaluar si më sipër, tejkalon kufirin e përcaktuar në pikën 2.3 të Licencës së prodhimit të energjisë elektrike, e cila përcakton se: çdo rritje e kapacitetit të instaluar, që kalon 10% të sasisë të kapacitetit të identifikuar në aneksin A, do të kërkojë një amendim të kësaj licence, atëherë kërkesa e shoqërisë “Kurum International” sh.a. i nënshtrohet vendimmarrjes së ERE-s për modifikimin e licencës.

- Me vendimet e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 132/2011 “Për licencimin e shoqërisë ‘HEC Ulez – Shkopet’ sh.a. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et Ulëz dhe Shkopet”, dhe nr. 136/2011, “Për licencimin e shoqërisë ‘HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2’ sh.a. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2”, licencat që mbanin shoqëritë “HEC Ulëz – Shkopet” sh.p.k. dhe “HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.p.k. janë transferuar te shoqëria “Kurum International” sh.a.

- Me ligjin nr. 94/2013, datë 4.3.2013, “Për ratifikimin e kontratës së shitjes së 100 % të aksioneve të shoqërisë ‘HEC Ulëz – Shkopet’ sh.a. të lidhur ndërmjet METE-s (sot MIE) dhe shoqërisë ‘Kurum International’ sh.a...”, është ratifikuar kontrata për shitjen e 100% të aksioneve nga shoqëria “HEC Ulëz – Shkopet” sh.p.k. te shoqëria “Kurum International” sh.a., duke kaluar HEC “Shkopet” në pronësi të “Kurum International” sh.a.

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “Kurum International” sh.a. ka plotësuar dokumentacionin si vijon: Neni 15, “Modifikimi i licencës”, pika 4, germa “a”, “b”, “d” dhe “e”.

- Nga ky aplikim rezulton gjithashtu se mungon dokumentacioni në vijim:

Neni 15, “Modifikimi i licencës”, pika 4:

- germa “c”: Shoqëria duhet të depozitojë vendimin me shkrim të organeve drejtuese të shoqërisë në të cilin shprehet vullneti i tij për këtë modifikim.

- germa “f”: Duke marrë shkas nga shkresa e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) se shoqëria “KURUM INTERNATIONAL” sh.a. mund të vijojë me lejen që disponon për shfrytëzimin e burimit ujor nëse nuk ka ndryshim të parametrave të shfrytëzimit hidrik, shoqëria duhet të bëjë me dije nëse ka respektuar me rigorozitet lejen aktuale që disponon dhe nëse e njëjta sasi uji mjafton dhe për prodhimin e energjisë elektrike për kapacitetin prej 28 mw.

- germa “g”: Në vijim të sa depozituar, shoqëria duhet të përcjellë në ERE edhe miratimin përfundimtar për lidhjen me rrjetin nga OST sh.a. për kapacitetin për të cilin kërkohet dhe modifikimi i licencës.

- Për dokumentacionin e munguar, do të njoftohet aplikuesi që ta depozitojë atë brenda afatit të përcaktuar nga ERE.

- Në kuadër të plotësimit nga aplikuesi të dokumentacionit thelbësor sipas kërkesave të rregullores, vlerësohet fillimi i procedurës për këtë aplikim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për modifikimin e licences nr. 213, Seria PM13P, miratuar me vendimin nr. 132, datë 6.12.2011 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s dhe transferuar me vendimin nr. 126, date 28.10.2013, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s te shoqëria “Kurum International” sh.a. për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-i “Shkopet” me kapacitet të instaluar 24 mw, si më poshtë:

Ishte: kapaciteti i instaluar 24 MW

Bëhet: kapaciteti i instaluar 28 MW

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti